

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe me sekretarja juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.K. nga Gj. rr. ‘’...’’nr... , për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik neni 378/6-1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti-Përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.139/18 të dt. 16.04.2018, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.**03.08.2018**, murr ketë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP.nr.139/18 e dt.16.04.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

**L. K.**, nga Gj. rr. ‘’...’’ nr ..., i biri i Sh. dhe i nënës H. e gjinisë K. data e lindjes ..., në Gj. ,ka të kryer shkollën e mesme , i martuar, invalid i luftës, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me ID..... .

### Ë s h t ë f a j t o r

**Sepse :**

-**Me dt.26.12.2017, rreth orës 15:00 min**, në Gj. ,ne afërsi te udhëkryqit ne rrugën ‘’S. P.’’,saktësisht afër ‘’....,duke drejtuar automjetin e tipit .... me tabela te regjistrimit .....,ka rrezikuar trafikun publik duke shkelur nenin 69 dhe 150 te Ligjit për rregullat e trafikut rrugor nr.05/L-088,duke vene ne rrezik jetën e njerëzve dhe pasurisë ,nga pakujdesia,edhe pse ka qene i vetëdijshëm se me një veprim te tille do vjen deri te pasoja e ndaluar, lehtas e ka marre se gjere tek ajo nuk do te vjen apo ne momentin e duhur do t’i shmanget, ne atë mënyrë qe me te arritur afër udhëkryqit ë rrugën ....’’,rruga ishte e ngarkuar me kalimtar dhe automjete ,i njëjti e ka neglizhuar situatën e krijuar para veturës se tij ,duke reaguuar me vonese ,ku si pasoje ka shkelur këmbësorin N.H. ,duke e goditur me gomën e pare te anës se djathtë ne këmbën e djathte ,i cili ne momentin kritik ishte duke kaluar rrugën nga ana e djathte ne te majte ne drejtim të automjetit ,me ç’ rast këmbësori N.H. pëson lëndime te lehta trupore te konstatuara me hollësisht ne ekspertizën mjeko-ligjore te Dr.N.H.e dt.07,02,2018

-**me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6/1 të KPRK-së.**

Andaj ,Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73dhe nenit 378 par.6-1 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-se ,të akuzuarin L.K. , e

### G J Y K O N

Dënimin me gjobë në shumë prej **200,00 € (dyqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh** pas plotfuqishmërisë , së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 46 par.4 të KPPK-së , i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 ( dhjetë ) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20,00 € (njëzet) euro**.

E dëmtuari N.H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **71.00 euro** (në emër të ekspertizës së komunikacionit 51,00 euro dhe në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 20 euro) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00 euro**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-urdhri ndëshkimor të marr formë të prerë, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP.nr.139/18 të dt. 16.04.2018, ndaj të akuzuarit L.K.nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6/1 të KPRK-së .

Komfor nenit 493 të KPPK-së , Propozoj që ndaj të akuzuarit L.K. të nxirret U.N. me të cilin të njëjtit do t i shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 378 par. 6/1 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj veprë penale parasheh dënim me gjobë apo me burgim gjerë në 3(tre) vjet.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 493 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH - DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi penal me numër të rastit . ... i dt.26.12.2017,
- Raporti i hetuesit mbi vend shikimin aksidentit me numër të rastit nr....., i dt.26.12.2017,
- Skica nga vendi i ngjarjes të .... dt. 26.12.2017,
- Raporti i aksidentit me numër të rastit ..... i dt.26.12.2017,
- Raporti i emergjencës me numër 17590 dt. 26.12.2017
- Deklarata e të dëmtuarit N.H. dhënë në St.Policor me dt.26.12.2017,
- Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit M.Eng.L.S. të dt. 25.02.2018,
- Akt -ekspertiza mjeko –ligjor Dr . N.H. i të dt.07.02.2018,
- Foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera në lëndë.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPK-së në mënyrë që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**P.nr.283/18 të dt.03.07.2018**

**Sekretare juridike**  
**Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja**  
**Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës Gjyqtare të kësaj Gjykate. Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.